

Imagjino të shkosh të flesh në shtratin tënd dhe të zgjohesh në një varkë.

Cilat janë pyetjet e para që do t'u bëje atyre përreth teje?

*Si arrita këtu?*

*Çfarë jam dukë bërë këtu?*

*Ku jam duke shkuar?*

Këto janë pyetje të rëndësishme sepse ti je gjuajtur në një varke. Varka po lëviz përpara dhe ti dëshiron të dish ku është duke shkuar. Kurioziteti yt në këtë aspekt është valid.

Ti je gjuajtur në jetë. *Si erdhe këtu? Çfarë je duke bërë këtu? Ku je duke shkuar?*

Ti je fëmiju i nënës tënde. Ajo është fëmiju i nënës së vetë. Nuk mund të këtë një regres infinit të prindërve, përndryshe nuk do të kishe fëmijë fare. Njerëzit, sikurse edhe gjithë kafshët, erdhën prej tokës. E gjithë jeta erdhi prej tokës. Toka është pjesë e univerzit. Univerzi kishte një fillim.

Nuk do të mund të kishte pasur më parë një numër infinit të gjërave që i kanë paraprirë univerzit, përndryshe univerzi nuk do të kishte ardhur në ekzistencë. Edhe nëse univerzi nuk kishte një "fillim," patjetër që duhet të ishte i varur në dicka. Nuk mund të këtë një regres infinit të gjërave të varura, përndryshe gjithçka tjetër do të varej në diçka tjetër; një numër infinit i dominove që bijnë mbi njëra tjetren. Kështu pra, ishte një *shkak i parë i pashkaktuar dhe i përjetshëm* - fillues i gjithçkaje që ekziston, një fillues që nuk kishte fillim në vetëvete. Kjo është menyra e vetme e të shpjeguarit të ekzistencës së çfaredo gjëje. Ti përfundimisht ishe i shkaktuar nga kjo gjë e përjetshme dhe e pavarur.

Univerzi është i organizuar përderisa vazhdon të ekzistojë dhe të lejojë zhvillimin e jetës në të. Nëse për këtë është përgjegjëse 'e pavarura' që përmendëm më herët, atëherë kjo e pavarur duhet të ketë dituri dhe vullnet. Univerzi ekziston në një menyrë e jo në një tjetër. Kjo është dëshmi se është bërë një zgjedhje për atë se si univerzi duhet të jetë. Pra, shkak i parë duhet të këtë vullnet. Ekzistojnë ligjet e natyrës. Shkak i parë është përfundimisht përgjegjës për ekzistencën e këtyre ligjeve, pasi që pa shkakun e parë asgjë tjetër nuk do të ekzistonte.

Tani ti e di se prej nga ke ardhur. Ke ardhur prej shkakut të parë të pavarur që nisi gjithçka dhe që përfundimisht është përgjegjës për të gjitha gjërat që ekzistojnë. Nuk ke ardhur nga 'asgjë' sepse diçka e tillë është e pamundur. Ti nuk e ke krijuar veten, pasi që diçka e tillë është poashtu e pamundur. Nuk kishte një regres infinit të gjërave të krijuara ose të varura sepse dicka e tillë është e pamundur.

*Ku je duke shkuar?*

Ti do të vdesësh. Por çfarë ndodh pas saj [vdekjes]? Kur ti humb vetëdijen, sheh ëndrra. Mund të jesh duke fjetur, por ti prape përjeton një realitet në gjendjen tënde të pavetëdijshme. Nëse është

kështu atëhere pse në supozojmë që të gjithë realitetet do të mbarojnë kur vetëdija është përfundimisht e humbur?

*Çfarë je duke bërë këtu?*

Ti duhet të jesh duke bërë atë që gjithçka tjetër në natyrë është e detyruar të bëjë: duke i'u bindur rregullave të natyrës. Ndryshe nga gjithçka tjetër në krijim, ti ke një zgjedhje që t'i bindesh rregullave apo jo.

*Si t'i bindesh rregullave të natyrës?*

Në fillim duhet të dish se cilat janë ato rregulla dhe të kesh dëshmi se ato janë prej shkakut të parë dhe të pavarur që të ka sjellur në ekzistencë.

Shkaku i parë mund të jete vetëm një. Shkaku i parë duhet të jete i pavarur dhe i vetë-mjaftueshëm. Kjo do të anulonte ekzistencën e dy të pavarurave. Nacionët trinitare dhe politeistike për këtë shkak janë invalide pasi që ato supozojnë ekzistencën e më shumë se një të pavarure. Në trinitet, Ati është i plotfuqishëm, Biri është i plotfuqishëm, dhe Shpirti i Shenjtë është i plotfuqishëm. Porse nuk janë tre të 'plotfuqishëm' - vazhdon teoria e gabuar - por vetëm një i plotfuqishëm. Kjo, logjikisht dhe gjuhësisht është e pamundur dhe kontradiktore. Sipar pëcaktimit, nuk mund të ketë shumë të 'plotfuqishëm.' Për arsyen e njejtë, nuk mund të ketë më shumë se një shkak përfundimtar apo krijues. Nuk mund të ketë më shumë se një vullnet përfundimtar, përndryshe do të kishte kaos kozmik dhe mos-organizim. Çfarë nëse këta të 'plotfuqishëm' kompromisojnë mes vete? Nëse kompromisojnë atëherë do të thotë se ata janë të dobët dhe nuk janë të plotfuqishëm, pasi që një entitet i plotfuqishëm nuk ka nevojë të kompromisojë.

Shumë njerëz kanë thënë të kenë pranuar udhëzim hyjnor nga ligjbërësi. Këta njerëz përfshijnë Davidin, Solomonin, Moisiun, Krishtin dhe Muhamedin. Dëshmia historike jashta-Biblës është prezente për shumë prej këtyre njerëzve, sikurse Davidi, Solomoni, Krishti dhe Muhammedi. Të gjithë këta profetë kanë thënë se janë inspiruar prej Zotit dhe kanë adhuruar Një Zot. Të gjithë këta profetë, sipas Biblës dhe Kuranit, kanë pretenduar të jenë Profete për kohën dhe popullin e vetë. Profeti Muhammed ka thënë të jetë i dërguar për të gjithë kohët dhe popujt. Çfarë dëshmi ekziston për këtë?

Në moshën 40 vjecare, Profeti Muhammed shkoi në një shpellë në Mekke, dhe tha se një engjull (Engjulli Gabriel) i foli atij. Ai tha se Engjulli i tha atij: "Lexo në emrin e Zotit tënd që krijoi; krijoi njeriun prej një droçke. Lexo — Zoti yt është më Bujari. Ai mësoi njeriun me penë; i mësoi atij atë që nuk dinte" (Kuran 96: 1-5). Ai pohoi se ishte i dërguari i fundit për të gjithë njerëzimin. Konfirmoi profetësinë e Abrahamit, Noas, Moisiut dhe Jezu Krishtit. I thirri njerëzit të adhurojnë një Zot; të pavarurin. Atë që është "një dhe i vetëm, i vetëmjaftueshëm, që nuk ka fëmijë dhe nuk është fëmiu i askujt, dhe që askush nuk mund të krahasohet me të" (Kuran 112:1-4).

Kurani, që Profeti Muhammed thoshte të jetë fjala e fundit e Zotit, definon suksesin dhe qëllimin përfundimtar të jetës sikur në vazhdim: "Pasha Kohën, sigurisht njeriu është në humbje, përveç

atyre që besojnë, dhe bejnë vepra të mira, dhe këshillojnë njeri tjetrin drejt të vërtetës, dhe këshillojnë njëri tjetrin drejt durimit” (Kuran 103:1-3). Por çfarë dëshmi kishte Profeti Muhammed për profetesinë e tij?

### ***Dëshmia 1 - Ruajtja e Kuranit***

Kurani thotë: “Në sigurisht e kemi dërguar përkujtuesin [Kuranin] dhe ne sigurisht që do ta ruajmë atë” (Kuran 15: 9). Nëse një libër është i dedikuar për të gjithë njerëzimin, është e rëndësishme që marrësit kryesorë të tij, e poashtu edhe ata që vijnë pas tij të kenë qasje të njejtë tek libri. Kurani është i ruajtur oralisht nëpërmjet manuskripteve dhe nëpërmjet gjuhës së gjallë arabe. Variantet tekstuale të manuskripteve dhe të formateve të recitimit janë të shpjeguara nëpërmjet faktit se Profeti Muhamed kishte ajete të caktuara të shpallura në dialtekte të ndryshme. Kurani është i ruajtur nëpërmjet transmetimit masiv që nga koha e shokëve të Profetit Muhammed e deri më sot. Në dimë të gjithë emrat e të gjithë autoriteteve që kanë memorizuar Kuranin, që nga koha e Profetit Muhammed. Librat sikurse *Tabaqaat al-Qurraa'* me autor dijetarin e shekullit të katërmbëdhjetë Ibn al-Jazari, përmbajnë emrat dhe dëshmitë e të gjithë autoriteteve që kanë pranuar Kuranin nga Profeti Muhammed. Poashtu kemi edhe manuskripte tjera sikurse manuskripti në Topkapi të Turqisë, që ka datë të karbonit kohën e Uthmanit (njëri prej shokëve të ngushtë të Profetit Muhammed).

Për kontrast, Bibla nuk është e ruajtur. Librat e Testamentit të Ri për here të parë u listuan nga Athanasius në shekullin e katërt. Ai nuk kishte autoritet të dhënë nga Zoti. Në Krishterim ka ndryshim mendimesh për atë se sa libra janë në Kanonin Biblik. Protestanët thonë se janë 66 libra; Katolikët thonë 74; Krishterët Ortodoks Etiopianë thonë 81. Ka shumë manuskripte të Testamentit të Vjeter dhe të Ri, e kurse asnjë metodë për harmonizimin e varianteve kontradiktore të manuskripteve. Çfarë është interesante të theksohet është se Kurani edhe pse ka variante të leximeve dialektore, asnjëra prej këtyre leximeve nuk janë kontradiktore dhe të gjitha ato ishin të legjitimizuara nga Profeti Muhammed.

Disa versete rrënjësore së fundmi janë larguar nga disa versione të Bibles për arsye se janë konsideruar si interpolime. Këto përfshijnë për shembull versetin në vazhdim: “Janë tre që mbajnë regjistrin në qiell: Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjte; dhe keta të tre janë një” (1 Xhon, 5:7). Nëse udhëzimi i Zotit është për të gjithë njerëzit, nuk mund të këtë konfuzitet për atë se cka është fjala e Zotit.

### ***Dëshmia 2 - Pa Kontradikta***

Kurani thotë: “Nëse ky liber është prej dikujt tjetër e jo prej Zotit, ata do të kishin mundur të gjejnë shumë kontradikta në të” (Kuran 4:82). Kurani është libri religjioz i vetëm që në menyrë indirekte sfidon njerëzit të gjejnë kontradikta në të. Sikurse do të shohim në vazhdim, librat e tjere fetare (sikurse Bibla) janë të gatuar me kontradikta. Mungesa e kontradiktave në një libër nga Zoti ndoshta nuk është kusht i mjaftueshëm, po së paku është i nëvojshëm. Fakti se librat e tjerë fetarë kanë kontradikta i diskualifikon ato libra prej të qenurit të konsideruar si ‘mesazhi i Zotit.’

### ***Dëshmia 3 - Sfida e Kuranit***

Kurani thotë: “Nëse jeni në dyshim për atë se çfarë i kemi dërguar robërve tanë, prodhoni një kapitull sikurse ai [Kurani] nëse jeni të sigurtë dhe sjellni dëshmitarët tuaj [zotërat] pos Allahut” (Kuran 2:23). Kjo sfidë e të prodhuarit të dickaje sikurse Kurani i’u ishte drejtuar drejtëpërsëdrejti arabëve të asaj kohe, që ishin ekspertë në gjuhë. Shumë provuan por askush nuk mundi të prodhoje një tekst me ndonjë ndikim sociologjik të krahasueshëm me Kurantin.

### **Dëshmia 4 - Profecite në Islam**

Kurani dhe Hadithi (që janë thënje të Profetit Muhammed të inspiruara nga Zoti) kanë bërë një numër të parashikimeve për të ardhmen. Disa prej tyre janë:

1 - Perandoria Romake do të mposhte Perandorinë e Persise në një kohë kur Perandoria Romake ishte në prag të shkatërrimit, dhe se kjo do të ndodhte brenda 3-9 vjeteve. Kjo profeci u materializua sikurse që u shpall në Kuran; shih Kuran 30:1-6.

2 - Muslimanët ndërluftues do të kapin Gadishullin Arabik. Shih Kuran 24:55.

3 - Islami do të shpërndahet në lindje dhe perëndim të Egjiptit, Jemenit, Perandorisë Romake, dhe Perandorisë se Persise. Shih Hadithin e Theubanit në Sahih Muslim.

4 - Do të këtë rritje të imoralitetit seksual, dhe si rezultat i kesaj, të sëmundjeve të transmetuara seksualisht.

5 - Arabet këmbëzbathur do të konkurojnë mes vete të ndertojnë ndërtesa të larta. Shih Hadithin e Umarit në Bukhari.

Për shpjegim më të detajuar të këtyre profecive, e poashtu të krahasimeve të tyre me ato të feve të tjera, libri *The Forbidden Prophecies* (Profecitë e Ndaluar) mund të shkarkohet pa pagese nga website-i i ERA këtu:

<https://iera.org/shop/the-forbidden-prophecies/>

### ***Dëshmia 5 - Kosmologjia Kuranore***

Në krahasim me fetë tjera Abrahamike, është e qartë që Kurani është libri i vetëm që lejon për një kosmologji të një toke të rumbullakët dhe zgjerim të univerzit në interpretim literal (fjalëperfjalshëm). Më e afërta që Bibla i afrohet në referencë të rumbullakësisë së tokës është referenca për ‘rrethin e tokës’ (Isaiah 40:22, Psalmi 75:3). Mirëpo është e qartë se kjo është duke i’u referuar një toke të rrafshët që është e mbështetur nga shtyllat.

Nëpërmjet interpretimit direkt, kosmologjia Kuranore lejon për një model të tokës se rumbullakët dhe një univerzi që zgjerohet. Dijetarët literalist para-modern sikurse Ahmed ibn Hanbal and Ibn

Hazm kanë interpretuar Kuranin që sugjeron se toka është e rumbullakët, duke u bazuar në Kuran 39:5 - shih *Kitaab Al-Fasl fi al-Milal wa al-Ahwa' wa al-Nihal* (2/78). Në këtë varg fjala operative në arabisht është 'jukairu' që do të thotë "të mbështjellat në një top 'kurah'". Nga kjo, Ibn Hazm argumentoi se është e pamundur që nata dhe dita të mbështjellen në një top nëse toka ishte e rrafshët.

Narrativa Kuranore e krijimit është poashtu radikalisht ndryshe prej asaj të prezentuar në Gjenezë, ashtuqë nuk bie në kundërshtim me veten. Në Gjenezë përshembull flitet për krijimin e dritës, mëngjesit, dhe mbrëmjes në ditën e parë, të gjitha këto para krijimit të ndricuesve në ditën e katër. Në Isaiah 30.26 shpallet se "hëna do të shkelqejë po aq sa dielli" dhe se dielli do të shkëlqejë shtatë herë më shumë se zakonisht, '... sikurse të shtate ditët për njëherë' duke sugjeruar kështu se dielli po shkëlqente për shtatë ditë përkundër faktit që ai ishte krijuar në ditën e katër. Kontradikta tjera përfshijnë faktin se Gjenezë 1:11 thotë se bimët ishin të krijuara në "diten e tretë" kurse Gjenezë 2:5 thotë se "asnjë bimë nuk kishte lulëzuar ende". Kështu pra, jo vetëm që narrativa në Gjenezë hapazi nuk ka asnjë lidhje me fenomenet e observueshme natyrore, porse është në kundërshtim edhe me vetëveten. Këto kontradikta bënë që disa prej komentatorëve të hershëm të Biblës të refuzojnë interpretimin literal të këtyre narrativave (tregimeve), shih:

*Origen (2017) On First Principles, Book IV (translated by Behr, J.). Oxford, Oxford University Press pp.383/384.*

Duhet të theksohet poashtu se disa kanë shkruar shumë larg me këtë qasje, dhe efektivisht kanë mbivendosur kuptime shkencore në interpretimin Kuranor. Kjo është problematike pasi që shkencën nuk është e menduar të prodhojë të vërteta të përjetshme. Teoritë dhe 'faktet' e shkencës nganjëherë janë të rishikuara. Për këtë arsye nuk ka nevojë që Kurani të ndërlidhet në mënyrë perfekte me diskursin shkencor të shekullit 21, pasi që vetë ky diskurs është subjekt i ndryshimit. Më të thënë këtë, Kurani funksionon në një nivel multi-dimenzional që lejon njerëzit nga të gjithë gjeneratat të përfshihen kosmologjikisht me të.

## ***Dëshmia 6 - Biologjia dhe Embriologjia***

Kurani dhe Hadithi autentik detajisht shpjegojnë se si njeriu zhvillohet në barkun e nënës. Termet që përdoren përfshijnë 'nutfah amshaaxh' (Kuran 76:2) që do të thotë "një perzierje e sekrecioneve femërore dhe mashkullore" për të treguar se edhe mashkulli dhe femra kontribuojnë gjenetikisht në procesin e fertilizimit. Fjala 'alakah' (droçke), që literalisht do të thotë "të ngjitet në dicka", përdoret për të përshkruar fetusin. Kurani vazhdon në përshkrimin e 'mudgah' (mish i përtypur) si stad i zhvillimit, dhe stadet e mëtejshme që korrespondojnë me rritjen e muskujve dhe eshtrave (Kuran 23:14). Kurani poashtu përmend se të gjithë gjërat e gjalla janë krijuar prej ujit (Kuran 21:33). Është relativisht e lehtë t'i ndërlidhim këto staza Kuranore me zbulimet shkencore të shekullit 20 dhe 21. Kjo tregon se ndryshe nga diskursi Biblik, diskursi Kuranor nuk është i izoluar në Arabinë e shekullit të shtatëmbëdhjetë.

## ***Dëshmia 7 - Struktura e Kuranit***

Përkundër faktit që Kurani u shpall pjesë-pjesë për 23 vjet, ai jep një sens të pabesueshëm të të qenit i ndërthurrur. Në fjale tjera, *sureja* Kuranore (kapitulli) është e lidhur prej fillimit deri në fund, dhe fundi i një *sureje* është i lidhur me fillimin e *sure*s tjetër. Kjo mënyrë e petëzimit leksikor është një karakteristikë e pabesueshme e stilit Kuranor, dhe është e provueshme leksikisht nëpërmjet konstruktimit të fjalëve.

Një shembull për këtë është kapitulli i dytë i Kuranit, që mbaron me një lutje. Kapitulli i tretë i Kuranit poashtu fillon dhe mbaron me lutje. Shih Kuran 2:285.

Për më shumë informacione në lidhje me këtë, referohuni tek Raymon Farrin - Structure and Quranic Interpretation.

## ***Dëshmia 8 - Preciziteti Numerik***

Kurani ishte i shpallur me raste, që do të thotë se Profeti Muhammed nuk mund të parashihte se çfarë pyetje njerëzit do t'i bënin atij. Gjithsesi, Kurani ka precizitet marramendës kur vjen të përmendja numerike e disa fjalëve të caktuara. Për shembull, kur i përgjigjet të Krishtereve (që bënë çështjen për divinitetin e Krishtit duke u bazuar në atë se ai ishte i krijuar pa baba), Kurani thotë: 'Sigurisht që shembulli i Krishtit është sikurse ai i Adamit. Ai (Zoti) e krijoi atë prej pluhurit dhe tha bëhu! Dhe ai ishte' (Kuran 3:59). Çfarë është mahnitëse është se, për të theksuar këtë pike, emrat e të dyve, Adamit dhe Krishtit, përmenden saktësisht nga 25 herë në Kuran. Deri në këtë ajet (verset), të dy poashtu janë të përmendur saktësisht në numrin e njëjtë (shtatë herë secili). Ky është vetëm një prej shumë shembujve të saktësisë precize të Kuranit, që nuk është e mundur të shpiket në Kuran.

Është e rëndësishme të thuhet se përderisa disa njerëz kanë bërë lista të gjata të përmendjeve të supozuara të fjalëve të caktuara në Kuran, shumica e këtyre listave nuk kanë një standard të qëndrueshëm.

## ***Dëshmia 9 - Saktësia Historike***

Kurani ka një kapitull të tërë të dedikuar Profetit Josef. Bibla përmend ngjarjen e tij në Gjenezë. Dijetarët Biblikë dhe historianët vendosin hyrjen e Josefit në Egjipt në periudhën e Mbretërisë së Mesme.

Dokumente tjera dëshmojnë invazionin e Hyksos, një popull semitik që kishte uzurpuar kontrollin politik të Egjiptit gjatë periudhes prej 1700 deri 1550 PK (Para Krishtit). ... Është e mundur se ky popull ishte me favorizuesh ndaj njerëzve sikurse Josefi dhe familja e tij, dhe është poashtu e mundur që referenca për një faraon 'që nuk e njihnte Josefin' (Ekzodusi 1:8) flet për një periudhë kur lidhshipi Hyksos në Egjipt u refuzua në favor të një dinastie të re të mbretëve native Egjiptianë.

Coats, G.W. (1992) *Joseph*. In: Freedman, D. N., Herion, G. A. (eds.) *Anchor Bible Dictionary*. New York, Doubleday, p. 980.

Është interesante se kjo ishte koha kur fjala 'Faraon' nuk përdorej në referencë të udhëheqësve të Egjiptit. Kështu, historianët kritikojnë Biblen për përdorimin e fjalës 'Faraon' dhe e shohin si dëshmi për përzjerjen njerëzore, sikurse mund të shihet nga pjesa poshtë.

Përdorimi i titullit faraon mund të jete anakronik ashtuqë Moisiu duke folur për ngjarjet e patriarkëve në Egjipt përdorte shpesh termin e pranuar 'faraon' edhe pse ky titull nuk ishte i përdorshëm në kohën e patriarkëve (krahaso Gjenezë 12:15-20; 37:36).

Për më shumë informacione shih:

Elwell, W. A., Beitzel, B. J., Buckwalter, H. D., Craigie, P. C., Douglas, J. D., Guelich, R., & Hearn, W. R. (1988). *Baker Encyclopedia of the Bible (Vol. 2)*. Grand Rapids, Michigan, Baker Book House, pp. 1668-1669.

Është fascinuuese se Kurani përmend saktikisht udhëheqësin e Egjiptit në kohën e Josefit me termin 'Mbret' ('Malik' në Arabisht) përgjate gjithë kapitullit.

### ***Dëshmia 10 - Profecia Biblike e Muhmmedit***

Edhe pse e korruptuar, Bibla qëndron si një dokument historik interesant me mbetje të mundshme të fjalës së Zotit. Në Isaia 42:11, Bibla thotë:

Le ta madhërojnë Zotin shkretëtira dhe qytetet e saja;  
Le ta madhërojnë atë njerëzit e Kedarit!  
Ata që jetojnë në qytetin e Selas  
Të bertasin nga gezimi nga majat e maleve!

Sipas Gjenezës 25:13, Kedarët janë Arabët. Sela është emri i një vargmali në Medinë, qyteti i Profetit Muhammed. Kjo nuk mund të kishte qenë rreth Jezu Krishtit, pasi qe Krishti nuk i'u dërgua as Gadishullit Arabik, e as popullit Arab. Leximi në kontekst të tërë kapitullit tregon se ky njeri ishte 'dritë për Xhentilet' që luftuan dhe triumfuan ndaj armiqëve, dhe më pas shpërndanë drejtësinë në të gjithë botën.

### ***Përfundim***

Islami mëson se ne duhet të i'u dorëzohemi Zotit nëpërmjet veprave të mira sikurse pesë kohët e namazit, agjërimi në muajin e Ramazanit, të qenit i mirë ndaj prindërve, dhe dhënja në bamirësi. Islami poashtu mëson *xihadin*, një luftë fizike dhe metafizike kundër forcave të këqija sikurse Djalli. Kurani nuk thotë se ne duhet t'i detyrojmë të tjerët të konvertohen në Islam (shih Kuran 2:256). Në vend të kësaj, i jep njerëzve zgjedhjen për të marrë vendimin e duhur.

